

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Politika Tarifore për Grumbullimin e Mbeturinave

Dhjetor 2007

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Misioni

“Ofrimi i shërbimeve kualitative, efikase dhe të qëndrueshme, të gjithë konsumatorëve në Kosovë nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta”.

Vizioni

“Rregullimi i sektorëve të ujit dhe mbeturinave të ngurta me anë të metodave transparente dhe të drejta në pajtim me praktikën e mirë europiane e cila garanton sigurimin e shërbimeve kualitative, të qëndrueshme, të pranueshme dhe të sigurta nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta kudo në Kosovë, duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik”

Politika Tarifore për Grumbullimin e Mbeturinave

Përmbajtja

1.	HYRJE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1.1	DISPOZITAT MBI VENDOSJEN E TARIFAVE TË RREGULLORËS SË ZRRUM-IT (RREGULLORJA E UNMIK-UTNR. 2004/49).....	1
1.2	OBJEKTIVAT	1
2.	JURISDIKSIONI	2
2.1	NDËRMARRJET PUBLIKE (NP)	2
3.	OPCIONET THEMELORE TË POLITIKAVE TË TARIFAVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1	DREJTËSIA SOCIALE DHE STRUKTURAT E TARIFAVE.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.1	<i>Roli i NP lidhur me përgjegjësinë sociale.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.1.2	<i>Uniformiteti i tarifave</i>	<i>3</i>
3.1.3	<i>Nivelet e shërbimit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.1.4	<i>Tarifat fikse dha variabile.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2	MBULIMI I KOSTOS.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.2.1	<i>Përkufizimi</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2.2	<i>Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2.3	<i>Pritjet e efiçencës.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2.4	<i>Mbulimi i kostove kapitale të investimeve</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2.5	<i>Grantet dhe asetet e dhuruara</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.3	STRUKTURA E KAPITALIT, VLERA DHE KTHIMI	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.3.1	<i>Struktura e kapitalit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.3.2	<i>Vlera e kapitalit dhe kthimi në kapital.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.3.3	<i>Kapitali i punës</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.3.4	<i>Procesi i vënies së taksave</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
4.	PROCESI	7
4.1	SHQYRTIMET KRYESORE TË TARIFAVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.2	SHQYRTIMET E PËRKOHSHME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

1. HYRJE

1.1 Dispozitat e vendosjes së tarifave të Rregullorës së ZRRUM-it (Rregullore UNMIK-ut Nr. 2004/49)

Kjo politikë e lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) paraqet interpretimin dhe elaborimin e obligimeve ligjore lidhur me tarifat e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave

Veçanërisht, sipas Nenit 38 të Rregullorës së ZRRUM-it (*Rregullat e lëshuara nga Rregullatori*) kërkohet që ZRRUM-i të krijojë rregulla për vendosjen dhe aprovimin e tarifave. Kjo politikë është bazë mbi të cilën vendosen rregullat e tilla të detajizuara.

Neni 10 i Rregullorës së ZRRUM-it përshkruan obligimet e caktuara të vënies së tarifave duke përfshirë:

- Procesin e konsultimit (10.2)
- Pritjet e efijencës (10.3 b), dhe
- Mjaftueshmërinë në përmbushjen e shpenzimeve kapitale (10.3 d)

Obligimet ligjore, siç është paraparë në Rregulloren e ZRRUM-it, lejojnë një shkallë të diskrecionit rregullativ të bazuar në gjykimin profesional, kuptimin e entiteteve rregullative (dhe rrethanave specifike të tyre) dhe kriterin socio-ekonomik.

Si vazhdim të procesit inicial të konsultimit, në Maj 2007 dhe pikëpamjeve pasuese të palëve tjera është përfunduar kjo pasqyrë e politikave siç është përcaktuar më poshtë.

1.2 Objektivat

Interesat e palëve të ndryshme nuk përputhen domosdo; për shembull interesat e konsumatorit për çmimet e ulëta janë kontradiktore me interesat e investitorëve lidhur me qëndrueshmërinë financiare. Është detyrë e ZRRUM-it të sigurojë që çmimet të japin një balancim optimal në mes të këtyre interesave dhe vlerë më të mirë të mundshme duke përfshirë çmimin dhe kualitetin e përmirësuar të shërbimit për shoqërinë. Kjo politikë tarifore është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë balancimin më të mirë të përgjithshëm

2. JURISDIKSIONI

2.1 Ndërmarrjet publike (NP)

Ky dokument i politikave është i bazuar në mjedisin institucional ku shtatë ndërmarrje regjionale publike janë ofruesë të vetëm të licencuar të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Edhe pse ka disa ofruesë të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave që funksionojnë në Kosovë por aktivitetet e tyre në përgjithësi janë të kufizuara në grumbullimin e mbeturinave të konsumatorëve jo-shtëpiak (komercial, industrial dhe institucional) të cilat janë në funksionim ku tarifat janë vendosur sipas tregut të hapur konkurrues kështu që për aktivitetet e tilla nuk aplikohet politika tarifore rregullatore. Megjithatë, Ndërmarrjet Publike janë përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave nga amvisëritë të konsumatorëve shtëpiak dhe konsumatorëve jo-shtëpiak nuk i ofrohen shërbimet nga sektori privat. Këto ndërmarrje publike funksionojnë në mjedisin monopol dhe kështu që tarifat për shërbime janë të rregulluara nga ZRRUM-i në pajtim me Rregullorën 2004/49. Prandaj, kjo politikë tarifore kufizohet në aktivitetet e Ndërmarrjeve Publike. Sidoqoftë, si veçori kryesore e kësaj politike tarifore është promovimi i konkurrencës në sektor. Kështu që propozimet janë paraqitur me qëllim të mënjanimit të çrregullimeve në treg dhe në këtë mënyrë ka hapur rrugë sektorit për konkurrime më të gjëra. Është e ditur që korniza institucionale për mbeturinat (grumbullimi dhe deponimi) është duke u shqyrtuar dhe çfarëdo ndryshime aty mund të kërkojnë ndryshime pasuese në këtë politikë tarifore.

WCPS 1: Jurisdiksioni

Politika tarifore zbatohet vetëm për Ndërmarrjet Publike dhe nuk zbatohet për aktivitetet e ofruesve privat të shërbimit që funksionojnë në tregun konkurrues.

3. OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE

3.1 Drejtësia shoqërore dhe strukturat e tarifave

3.1.1 Roli i NP lidhur me përgjegjësinë sociale

Rregullorja 2004/49 (Neni 10.3 (f)) konstaton që tarifat duhet të përcaktohen në pajtim me 'përgjegjësia e Institucioneve të Përkohëshme të Vetqeverisjes e jo të ofruesve të shërbimeve është që të ndihmojë konsumatorëve me të ardhura të ulëta për të paguar faturat e tyre'. Si pasojë e kësaj, Ndërmarrjet Publike

duhet të lejohen që të funksionojnë plotësisht mbi bazën komerciale.

WCPS 2: Përgjegjësi sociale

Qeveria (lokale dhe qendore) është përgjegjëse për përmbushjen e nevojave të të varfërve duke përfshirë ndihmën për kryerjen e shpenzimeve të shërbimeve publike.

3.1.2 Uniformiteti i tarifave

Është e ditur që shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave mund të ndryshojnë në mes të Ndërmarrjeve Publike si shkak i shfrytëzimit të resurseve të mundshme, ekonomive të shkallës dhe faktorëve tjerë. Megjithatë, është e padrejtë që tarifat të ndryshojnë për shërbimet e njëjta brenda Ndërmarrjeve Publike pavarësisht nga kostot e shërbimeve. Prandaj, do të ishte e përshtatshme që strukturat e tarifave uniforme të aplikohen në çdo zonë të shërbimit të Ndërmarrjeve Publike.

WCPS 3: Uniformiteti i tarifave

Tarifat duhet të jenë uniforme në çdo zonë të shërbimit të Ndërmarrjeve Publike për shërbimet e ngjajshme.

3.1.3 Nivelet e shërbimit

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të konsumatorëve shtëpiak (dhe në disa raste edhe ata jo-shtëpiak) ndahen në dy kategori kryesore: të atyre që pranojnë shërbime individuale, p.sh. shtëpitë individuale dhe atyre që pranojnë shërbime komunale, p.sh. individët që jetojnë nëpër banesa. Kështu që do të ishte e përshtatshme nëse aplikohen dy tarifa të ndryshme për të reflektuar këto dy nivele të ndryshme të shërbimeve. Tarifa për shërbime individuale është më e lartë se e shërbimeve komunale që t'i reflektojë ndryshimet në shpenzimet. Kjo politikë tarifore i përkrahë por nuk i obligon Ndërmarrjet Publike të aplikojnë tarifat e ndryshme për këto dy nivele të identifikueshme të shërbimit.

WCPS 4: Nivelet e shërbimit

Secila ndërmarrje publike mund të vendos që të adoptojë dy struktura të tarifave që të reflektojë shpenzimet e shërbimeve individuale dhe komunale të grumbullimit të mbeturinave.

3.1.4 Tarifat fikse dhe variabile

WCPS 5: Tarifat fikse dhe variabile

Amvisëritë duhet t'i nënshtrohen pagesës fikse mujore për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ndërsa konsumatorët jo shtëpiak duhet të ngarkohen ose me tarifën fikse ose me atë volumetrike, kjo e fundit e bazuar në vlerën për kontejner (variabla që varet nga madhësia e kontejnerit)

3.2 Mbulimi i kostos

3.2.1 Përkufizimi

Karakteri afatshkurtë i biznesit të grumbullimit të mbeturinave duke përfshirë asetet afatshkurta, në mënyrë efektive e bëjnë përcaktimin e mbulimit të kostos sa më të thjeshtë dhe sa më të qëndrueshëm.

WCPS 6: Përkufizimi i mbulimit të kostos

Sipas kontabilitetit, mbulimi i kostos definohet në atë mënyrë kur të hyrat balancohen në bazë vjetore me të gjitha shpenzimet. Shpenzimet përfshijnë shpenzimet direkte operative, amortizimin, interesin dhe shpenzimet e tjera në pajtim me standardet kosovare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.

3.2.2 Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë kostos

Procesi i grumbullimit të mbeturinave operon në tregun ku ka konkurrim të hapur dhe prandaj duhet menjëherë të operojë në bazë të mbulimit të plotë të kostos. Shtyerja e mbulimit të kostos është çrregullim i tregut dhe e dekurajon konkurrimin.

WCPS 7: Afati kohor për arritjen e mbulimit të kostos

Mbulimi i kostos është një qëllim i drejtpërdrejtë

3.2.3 Pritjet e efiçencës

Pasi Ndërmarrjet Publike funksionojnë në tregun konkurrues, nivelet e efiçencës duhet të jenë të krahasueshme me konkurrentët e tyre. Prandaj, tarifat duhet të bazohen në nivelet reale të tregut të efiçencës.

WCPS 8: Pritjet e përmirësimit të efijencës

ZRRUM-i duhet t'i përcaktoj tarifat duke u bazuar në pritjet të përmirësimit të efijencës në përputhje me nivelet reale të efijencës së sektorit privat.

3.2.4 Mbulimi i kostove kapitale të investimeve

Për shkak të aseteve afatshkurta të grumbullimit të mbeturinave (maksimumi 10 vjet) dhe niveleve të ulëta të inflacionit të pritur, në valutën EURO, amortizimi i thjeshtë i shpenzimeve historike konsiderohet të jetë një mjet i përshtatshëm për kthimin në kapital.

WCPS 9: Mbulimi i kostove kapitale të investimeve

Investimet kapitale duhet të përshihen në tarifat përmes amortizimit të plotë të shpenzimeve historike.

3.2.5 Grantet dhe asetet e dhuruara

Ndërmarrjeve Publike i përshtatet pozita e zotërimit të aseteve të dhuruara (ose aseteve të financuara përmes granteve). Asetet e tilla e japin Ndërmarrjeve Publike përparësi jo të drejtë përmes konkurruesve të tyre. Sidoqoftë, çrregullimet e tilla janë me natyrë afatshkurte pasi që asetet e reja zëvendësuese do të duhen të blehen përmes resurseve të tyre financiare. Kështu që do të ishte mirë që amortizimi të lejohet në asetet e tilla të dhuruara apo/ose të financuara me grante për të kaluar në tarifa edhe pse kjo i jep ndërmarrjeve publike të hyrat të cilat nuk janë të pëlqyeshme nga konkurrentët e tyre. Në afatin e mesëm çrregullimet e tilla do të zhduken automatikisht.

WCPS 10: Trajtimi i granteve dhe aseteve të dhuruara

Ndërmarrjet Publike duhet të përfshijnë amortizimin në asetet e dhuruara dhe të financuara me anë të granteve në strukturën e tyre të tarifave.

3.3 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi

3.3.1 Struktura e kapitalit

Teoria ekonomike konvencionale tregon se struktura e kapitalit nuk ka kurfarë ndikimi në performancën e biznesit dhe si e tillë është çështje e menaxhimit të KLMC-së e jo çështje rregullatore. Kështu që kthimi në kapital (kur të zbatohet) duhet të bazohet në kthimin e vlerës totale të kapitalit pavarësisht nga struktura kapitale. Në afat të shkurtë kohor, para arritjes së mbulimit të

plotë të kostos, ZRRUM-i duhet t'i përfshijë obligimet e borxheve ekzistuese të Ndërmarrjeve Publike (interesi dhe ri-pagimi i kryegjësë) në procesin e vendosjes së tarifave.

WCPS 11: Struktura e kapitalit

Në afat të shkurtë kohor, para arritjes së mbulimit të plotë të kostos, ZRRUM-i duhet të konsideroj strukturën e kapitalit në procesin e vendosjes së tarifave me qëllim të mbrojtjes së rrjedhjes së parasë. Pasi të arrihet mbulimi, ZRRUM-i duhet të konsiderojë strukturën kapitale të Ndërmarrjeve Publike si çështje të menaxhimit të tyre e jo si çështje rregullatore.

3.3.2 Vlera e kapitalit dhe kthimi i kapitalit

Natyra konkurruese e aktivitetit të grumbullimit të mbeturinave nuk kërkon zbatimin e rregullave të veçanta mbi përcaktimin e vlerës së kapitalit të rregullatorit. Vlera e kapitalit dhe kthimi në kapital duhet të bazohet mbi parimet e tregut konkurrues që reflekton vlerën e investimeve dhe rrezikun që lidhet me pritjet e investitorëve për kthimin

WCPS 12: Vlera e kapitalit dhe kthimi i kapitalit

Vlera e kapitalit të NP duhet të përcaktohet në bazë të kapitalit të tyre total (asetet përfshirë kapitalin e punës) dhe kthimi në kapital duhet të bazohet në pritjet e kthimeve për investimet e ngjajshme të rrezikut.

3.3.3 Kapitali i punës

Kërkesat e kapitalit të punës të Ndërmarrjeve Publike do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e parasë të organizatave dhe si të tilla do të pranohen në tarifën e shërbimit. Gjithashtu, pasi të lejohet kthimi në kapital në tarifa, vlera e kapitalit mbi të cilin mund të arrihet kthimi, duhet të përfshijë kërkesat e kapitalit të punës të Ndërmarrjeve Publike.

WCPS 13: Kapitali i punës

Niveli i rrjedhjes së parasë për Ndërmarrjet Publike duhet të përfshijë çfarëdo ndryshime në kërkesat e kapitalit të punës. Me arritjen e mbulimit të plotë të kapitalit dhe përfshirjen e kthimit në kapital në tarifën e shërbimeve, kapitali i punës duhet të përfshihet në kapitalin total mbi të cilin mund të kryhet kthimi.

3.3.4 Procesi i vënies së taksave

WCPS 14: Procesi i vënies së taksave

Taksat e pa-kompensueshme duhet të përfshihen në tarifa. Kur të përfshihet kthimi në kapital në tarifa, ai duhet të përcaktohet mbi bazën e post-taksës.

4. PROCESI

4.1 Shqyrtimet kryesore të tarifave

WCPS 15: Shqyrtimet kryesore të tarifave

Tarifat për vitin 2007/8 duhet të shqyrtohen çdo vit, në kohën ku politikat e tarifave mund të përpilohen me grup të kompletuar të rregullave që mundësojnë peridhat më të gjata në mes të shqyrtimeve.

4.2 Shqyrtimet e përkohshme

Në pajtim me Rregullorën 2004/49, neni 10.5, ZRRUM-i duhet t'i shqyrtoj tarifat çdo vit ose 'në kohë tjetër e cila caktohet në pajtueshmëri me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit me Shumicë...' ZRRUM-i duhet të vendos tarifa në mënyrë periodike me shqyrtim vjetor të kërkuar nga rregullorja që kufizohet në rregullimin e infacionit dhe rastet e jashtëzakonshme.

WCPS 16: Shqyrtimet e përkohshme

ZRRUM-i duhet të bëjë shqyrtime të përkohshme periodike të tarifave duke marrë parasysh inflacionin dhe ndryshimet e jashtëzakonshme në mjedisin operativ.